

KONTRATË
PËR SHIT - BLERJE TË KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR
TË SHOQËRISË “SOUTH ADRIATIC DEVELOPMENT” SH.P.K.

Në Tiranë, sot në datën 23. 12.2021 (dymjë e njëzete e një), në selinë e shoqërisë “South Adriatic Development” te ndodhur ne adresen Njesia bashkiake nr. 8, rruga “Qemal Stafa”, pallati 25, hyrja 4, apartamenti 4, perballe Qendres Lincoln., nënshkruhet kjo kontratë për shitjen e kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë “SOUTH ADRIATIC DEVELOPMENT” SHPK si me poshtë:

“Peninsula Development” Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar, me seli në adresën Rruga “Dervish Bej Mitrovica”, Pallati “Kristi-Co”, nr.6, kati përdhe dyqani nr. 1, Tiranë, Shqipëri, regjistruar pranë Regjistrat Tregtar Shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me numrin unik identifikimi NUIS – M12206056V, përfaqësuar rregullisht në këtë kontratë nga Z.Idlir Lopçi në cilësinë e administratorit:

Z. Idlir Lopçi, shtetas Shqiptar, lindur në 21.09.1969 dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID nr.035649242 dhe nr. personal G90921090D (i quajtur më poshtë “Shitësi”)

DHE

“Smart Construction Invest” Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar, me seli në adresën Rruga “Qemal Stafa”, pallati 25, hyrja 4, apartamenti 4, perballe Qendres Lincoln, Njesia Bashkiake nr.8, Tiranë, Shqipëri, regjistruar pranë Regjistrat Tregtar Shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me numrin unik identifikimi NUIS – M12129013M, përfaqësuar rregullisht në këtë kontratë nga Z.Redi Struga në cilësinë e administratorit:

Z. Redi Struga, atësia Bujar, amësia Mirlinda, lindur më Tiranë në 22.09.1982 dhe banues në Rruga “Bardhyl”, nd.22, hyrja 1, njësia administrative nr. 3, Tiranë me Leternjoftim ID nr. Personal I20922121O dhe nr. personal I20922121O (i quajtur më poshtë “Blerësi”)

MEQËNESE:

- A. “Peninsula Development” Sh.p.k., dëshiron t'i shesi “Smart Construction Invest” Sh.p.k. 10 % te kuotave të saj që zotëron në shoqërinë “South Adriatic Development” sh.p.k.
- B. “Smart Construction Invest” dëshiron të blejë nga “Peninsula Development” Sh.p.k. 10% të kuotave që ajo zotëron ne shoqërinë “South Adriatic Development” sh.p.k.

PËR SA MË SIPËR, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, si dhe Ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare Të Biznesit” me ndryshimet e mëvonshme, referuar Akt Themelim e Statut i Shoqërisë “South Adriatic Development” sh.p.k. konkretisht nenit 10 të tij, si dhe mbi bazën e Vendimit të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Përbajtja e Kontratës

Shoqëria Tregtare “South Adriatic Development” sh.p.k. është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me datë 15/10/2021 me Nr. NIPTI: M12215020U. Shoqëria është themeluar me një kapital themeltar të regjistruar prej 2 (dy) kuotash në vlerën nominale 400,000,000 (katërqind milion) Lekë.

Me vendimin e datës 23.12/2021 të Asamblesë së Ortakeve të kësaj Shoqërie është vendosur miratimi i shitjes së kuotave të kapitalit themeltar në masën 10% nga ana e Ortakut Shoqëria “Peninsula Development” shpk dhe blerja e tyre nga ana e Shoqëria “Smart Construction Invest” shpk në masen totale 10% të kuotave të kapitalit themeltar të shitura.

Shitësi është plotësisht dakort të shesi me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë kuotat e kapitalit themeltar sipas masës (përqindjes) që ai zotëron në Shoqërinë “South Adriatic Development” sh.p.k.

Blerësi Shoqëria “Smart Construction Invest” shpk është plotësisht dakort që të blejë me vullnetin e saj të lirë e të plotë masën (përqindjen) e kuotave të zotëruara nga shitësi në kapitalin themeltar të shoqërisë “South Adriatic Development” sh.p.k.

Mënyra e kalimit të pronësisë së kuotave

Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, shitja e masës prej 10% të kuotave totale të kapitalit themeltar të Shoqërisë “South Adriatic Development” sh.p.k. te zotëruara nga ana e Shoqëria “Peninsula Development” shpk dhe blerja e tyre nga ana e “Smart Construction Invest” shpk sjell humbjen e të drejtës së pronësisë së shitësit mbi kuotat e shitura, si pasojë e këtij transaksioni shit-blerje.

Ndërsa blerësi “Smart Construction Invest” shpk bëhet pronar i kuotave të shitura më sipër, ne masen prej 10% te kapitalit themeltar, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart blerja e këtyre kuotave, duke fituar kështu cilësinë e ortakut me pjesmarrje 60% në Shoqëri.

Mbas nënshkrimit të këtij Akti e pasqyrimit në QKB, Shoqëria “South Adriatic Development” sh.p.k. pëson këto ndryshime:

- Shoqëria “South Adriatic Development” sh.p.k. do të ketë Ortak të saj Shoqëria “Smart Construction Invest” shpk zotërues të 60% të kapitalit të shoqërisë dhe Shoqëria “Peninsula Development” shpk zotërues të 40% të kapitalit themeltar te shoqërise.

Çmimi i shitjes së kuotave

Si cmim total i këtij transaksioni Shit-Blerje kuotash të Shoqërisë “South Adriatic Development” sh.p.k.do të jetë shuma prej 5,000 (pesë mijë) Lekë.. Kjo pagese do te likujdohet nga pala shitese brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate në llogarinë bankare të Shoqëria “Peninsula Development” shpk.

Sipas këtij përcaktimi, Blerësi “Smart Construction Invest” shpk do të paguajë në favor të Shitësit shumën si më poshtë vijon:

- Me nënshkrimin e kontratës, Blerësi “Smart Construction Invest” shpk do të paguajë në favor të Shitësit Shoqëria “Peninsula Development” shpk. shumën në masën 5,000 (pesë mijë) Lekë.

Dispozita të fundit

Kjo Kontrate hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin e saj nga palët, të cilat nuk mund të ndryshojnë kushtet e vendosura në të me pëlqimin e tyre.

Çdo mosmarrëveshje mes tyre palët angazhohen se do ta zgjidhin me mirëkuptim dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente pér gjykimin e konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


Kjo kontrate është hartuar në gjuhën shqipe, në përputhje të plotë me vullnetin e lirë të palëve në 3 (tre) kopje të barasvlershme. Palët marrin nga një kopje dhe një kopje do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

SHITËSI

“Peninsula Development” Sh.p.k.
Sh.p.k.

Administrator

Idlir Lopçi



BLERËSI

“Smart Construction Invest”

Administrator

Redi Struga

